



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:240147

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647565

KPPP.nr. 1790/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Liridoni Distribution” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810213900 dhe me seli në Graçanicë, Magjistratja Prishtinë Ferizaj, km. 7, Llapnasellë, kundër debitorit K.B. B.I., me emër tregtar N.P.T. “Florenti”, me numër të unik identifikues 811305334 dhe me seli në Mitrovicë, rr. “Shemsi Ahmeti”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 287/2023 i datës 04.10.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, jashtë seancës me datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit K.B. B.I., me emër tregtar N.P.T. “Florenti”, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 287/2023 i datës 04.10.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Liridoni Distribution” Sh.P.K., me datë 04.10.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 287/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. SI-23-003-01431, e datës 17.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-12569, e datës 17.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-01432, e datës 18.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-12923, e datës 22.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-12924, e datës 22.05.2023 dhe Faturës nr. SI-23-003-01529, e datës 23.05.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 4,361.31 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbartimor me arsyetim se me kreditorin kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, ku kreditori ka marrë përsipër që të furnizojë debitorin me produkte të ndryshme në kompensim të kundërvlerës financiare, ashtu që çdo fund vit apo fillimin e vitit të ardhshëm kalendarik të bëjnë proces barazimin në koordinim të përbashkët për konfirmimin e saldove financiare. Ka shtuar se faturat nuk janë të përshtatshme si dokument përmbartimor sepse koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur me barazimin e obligimeve financiare dhe në kundërshtim me marrëveshjen që të kërkohet çfarëdo kompensimi i mjeteve pa barazimin e obligimeve. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimi i debitorit se faturat nuk janë dokument i përshtatshëm për përmbartim nuk qëndron pasi që të njëjtat kanë të gjitha elementet e një dokumenti të besueshëm për përmbartim, e po ashtu edhe afatin e pagesës, të cilin debitori e ka pranuar çdo herë me nënshkrimin dhe vulën e secilës faturë. Ka shtuar se debitori i referohet kontratës për furnizim për vitin kalendarik 2018, e cila nuk ka të bëjë me periudhën e borxhit që kërkohet me urdhrin për përmbartim. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. SI-23-003-01431, e datës 17.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-12569, e datës 17.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-01432, e datës 18.05.2023;

Faturës nr. SI-23-002-12923, e datës 22.05.2023; Faturës nr. SI-23-002-12924, e datës 22.05.2023 dhe Faturës nr. SI-23-003-01529, e datës 23.05.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përbarimit pasi që janë të përshtatshme për përbarim.

Gjykata pati parasysht pretendimet e debitorit se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përbarimor nuk janë të përshtatshme për përbarim, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se faturat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori, ashtu që nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1790/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.